



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 173, datë 07.11.2019

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “E - VENTO S.R.L ALBANIA” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 84, DATË 17.07.2008, I NDRYSHUAR.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenin 67, nenin 85 dhe nenin 114, pika 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe të nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 07.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 101/6 Prot., datë 31.10.2019 të Drejtorisë së Licensimit, Autorizimeve dhe Mbykqyrjes, lidhur me “Kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, për shtyrjen e afateve të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008 i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “E-Vento S.R.L Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 649 Prot., datë 16.10.2019, i është drejtuar ERE-s, duke kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licensës, për shkak të problematikave të hasura përtej vullnetit dhe investimit të saj financiar dhe administrativ.
- Shoqëria “E-Vento S.R.L Albania” sh.p.k., është licencuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, në aktivitetin e “Ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë si dhe prodhimin e energjisë elektrike” prej tyre me kusht zbatimin e sa parashikuar në licencën tip, të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e “Ndërtimit dhe prodhimin të energjisë elektrike nga centrale eolike” (parku eolik Sarandë), si dhe kushteve të parashikuara në pikën 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, të këtij vendimi.
- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve të ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrik me erë për parkun eolik Sarandë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike prej tyre me vendimet :
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 63, datë 22.09.2009,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 55, datë 25.08.2010,
 - Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 134, datë 15.11.2013.
- Bordi i ERE me Vendimin nr. 87, datë 09.06.2016, ka vendosur:

1. Rrezimin e kërkesës së shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, për zgjatjen e afatit të licencës Nr. 60, Seria NPM08 dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin e Centraleve Elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike”.
 2. Fillimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, Nr .60, Seria NPM08 dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008.
- ERE me Vendimin e Bordit nr. 2, datë 10.01.2018, “Mbi shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 60, Seria NPM08, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, ka vendosur:
 - Shfuqizimin e Pikës 1 të Vendimit nr. 87, datë 09.06.2016 të Bordit të ERE-s “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento S.R.L Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të licencës nr. 60, Seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”, të dhënë me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar”.
 - Të mbyllë procedurën e nisur me Vendimin e Bordit të ERE-s nr .87 datë 09.06.2016, për heqjen e licencës nr. 60, Seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike”.
 - Shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura në pikën 1 të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar, për Shoqërinë “E-Vento S.R.L Albania” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 60, Seria NPM08P, “Për ndërtimin, instalimin, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike” deri në datën 15.11.2019.”
 - Për shkak të kompleksit të problematikës që i licencuari, shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., ka hasur për kryerjen e plotë të studimit të fizibilitetit, të etapave administrative nëpër të cilat kalon projekti i parqeve eolike, si një teknologji e re për vendin, argumentat shpjeguese të dhëna dhe depozituara në ERE nga shoqëria,
 - Duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në shkresën nr. 102/4 Prot., datë 27.04.2015, e cila ka ardhur si përgjigje e shkresës së ERE-s nr.14 Prot., datë 07.01.2015, ku i'u kërkua të bëjë me dije, mbi kompetencën institucionale të trajtimit të këtyre subjekteve në mbështetje të legjislacionit në fuqi, MIE bën me dije se: VKM, nr. 1701, datë 17/12/2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese që nuk janë objekt koncesioni”, nuk ka efekt prapaveprues dhe vlerësimi i kërkesave lidhur me licencat e miratuara nga ERE duhet të bëhet konform dispozitave ligjore, të cilat kanë qënë në fuqi në kohën e miratimit të këtyre licencave.
 - Shoqëria ka parashtuar se këto probleme dhe të tjera në kompleksitetin e tyre nuk kanë bërë të mundur plotësimin në kohë të kushteve të vendimit të licencimit dhe kërkon nga ERE shtyrjen e afatit të kushteve të vendimit të licencimit, duke vënë theksin tek fakti që ky është një investim shumë i madh, i cili kërkon besim të ndërsjelltë tek palët.
 - Leja e sheshit të ndërtimit ka qënë një ndër pengesat kryesore për fillimin e punës në këtë impiant. Komunitat Livadhja, Lukovë e Markat të rrethit Sarandë kanë ndërhyrë me vonesë për lirin e sheshit të ndërtimit duke argumentuar kohën e nevojshme të kalimit të

pronësisë nga pushteti qendror në atë lokal. Shoqëria bën me dije se në këtë moment ky problem ka gjetur zgjidhje në mënyrë përfundimtare dhe ka nisur procedura e blerjes së tokës në të cilën do të vendosen turbinat.

- Hapja e rrugëve për vendosjen e aparaturave matëse ka qenë një tjetër arsye për vonesën për fillimin e punës. Shoqëria bën me dije se, për vendosjen e aparaturave në Markat është hapur 1.2 km rrugë e re dhe është përmirësuar rreth 12 km rrugë. Për të vendosur aparaturat në komunën Livadhja është përmirësuar një gjatësi rruge prej 10 km dhe është hapur rrugë e re prej 800 ml. Për të vendosur aparaturat në komunën Lukovë është përmirësuar një gjatësi rruge prej 4 km dhe është hapur rrugë me gjatësi 1 km. Shoqëria argumenton se, me zgjidhjen përfundimtare të problemit të pronësisë së tokës, është vijuar me hartimin e projekteve të plota të rrugëve kryesore e atyre lidhëse. Shoqëria deklaron se do të përcjellë në ERE projektet e realizuara nga studio përkatëse e kontraktuar për këtë qëllim. (Shoqëria ZENIT&CO sh.p.k).
- Në lidhje me Procedurat Doganore shoqëria bën me dije se është kryer zhdoganimi i të gjithë aparaturave për testimin e shpejtësisë së erës.
- Dëmtimi i Anometrit në komunën Lukovë gjatë vitit 2010, ka bërë që shoqëria të vendosë aparatura të reja me kosto shtesë për të.
- Kushti i vendosur nga banka ka qenë që testimi të bëhet nga kompani të licencuara dhe të njohura prej tyre në këtë fushë. Nga ana e shoqërisë ky kusht është realizuar dhe konkretisht matjet dhe testimet në impiant i ka realizuar shoqëria “TECNOGAIA s.r.l”, e njohur nga bankat dhe ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me to për këtë veprimtari. Shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k, bën me dije se banka hollandeze pretendon se duhet ti ribëjë matjet me një kompani që njihet nga kjo bankë për të siguruar mbështetjen e plotë financiare. **Konstatohet se kemi një zëvendësim të bankës dhe shoqërisë që do të ribëjë testimin e erës. Shoqëria “TECNOGAIA” është zëvendësuar me kompaninë hollandeze “BS-GREEN ENERGY”, për të siguruar financimin.**
- Sa i përket marrëveshjes për pikën e lidhjes me sistemin elektroenergjitik shoqëria ka deklaruar se do të përcjellë në ERE detajimin e plotë të lidhjes me sistemin e transmetimit shqiptar të energjisë, të detajuar për secilën lidhje.
- Rezulton se shoqëria “E Vento s.r.l Albania” sh.p.k., ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Nga argumentat, spjegimet dhe dokumentacioni i përcjellë nga aplikuesi me qëllim shtyrjen e afteve të parashikuara në pikën 1, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “Për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k., nuk rezulton të jenë dhënë prova të mjaftueshme dokumentare të tilla që të çojnë ERE-n në marrjen e një vendimi për miratimin e kërkesës për shtyrje.
- Neni 67 i kodit të Procedurave Administrative parashikon se :
 1. Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.
 - 2.Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara.

- Kodi i procedurave Administrative në nenin 85, pika 3 të tij parashikon se ; *Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.*
- Në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, sic parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE mund të ushtrojë aktivitetin e saj monitorues me qëllim marrjen e të gjithë informacionit të nevojshëm nga i licencuar, për të krijuar bindjen e plotë e të arsyeshme se kërkesa e paraqitur, plotëson kushtet ligjore, administrative dhe teknike për t’u pranuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “*E-Vento s.r.l Albania sh.p.k*” për shtyrjen e afateve të parashikuara në pikën 1, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “*Për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania sh.p.k.”*, i ndryshuar, dhe së fundmi me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 2, datë 10.01.2018, deri në përfundimin e monitorimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.
2. Të ushtrojë monitorim të thelluar pranë subjektit “*E-Vento s.r.l Albania sh.p.k.*” për të evidentuar, dokumentuar e shyrtuar të gjitha rrethanat të cilat aplikuesi pretendon se i kanë pamundësuar zbatimin e kushteve dhe afateve të parashikuara në Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “*Për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania sh.p.k.”*, i ndryshuar,
3. Afati i pezullimit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përfundon jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Aplikuesi, shoqëria “*E-Vento s.r.l Albania sh.p.k*” është përgjegjëse për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim, në afat.
5. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja dijani, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI